



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Eco Logic LLC" të datës 23.06.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Liceut Artistik - Ndërtesa kryesore" me nr. të prokurimit 616-25-4150-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET si e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Eco Logic LLC" të datës 23.06.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Liceut Artistik - Ndërtesa kryesore" me nr. të prokurimit 616-25-4150-5-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Eco Logic L.L.C." (tutje "parashtruesi") me datë 23.06.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Liceut Artistik - Ndërtesa kryesore" me nr. të prokurimit 616-25-4150-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merititor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

AK- Komuna e Prishtinës në Formularin B54- NJOFTIM PER INFORMATA SHITESHE ose PERMIRESIM I GABIMIT të publikuar në Platformën e E-Prokurimit me datën 16.06.2025 dhe Dosjen e Tenderit të Korrigjuar me datën 13.06.2025, të kapacitetet Teknike dhe Profesionale ka kërkuar:

Pretendimi 1:

1. OE të ketë min. dy kontrata të ndërtimit me kompleksitet të njëjtte në vlerë secila min. 3.0 mil. EUR.

Kërkesa për dy kontrata të ndërtimit me kompleksitet të njëjtte në vlerë secila min. 3.0 mil. EUR, është kërkesë jo në proporcion me aktivitetin e prokurimit dhe që e kufizon shumë konkurrencën.

Kërkojmë nga AK- që kërkesa për dy kontrata të ndërtimit me kompleksitet të njëjtte në vlerë secila min. 3.0 mil. EUR të ndryshohet dhe të zvogëlohet numri i kontratave.

Pretendimi 2:

16.-Tre Saldues për gyp HDPE, të çertifikuar sipas EN-13067.

Kërkesa për Tre Saldues për gyp HDPE, të çertifikuar sipas EN-13067 është kërkesë jo në proporcion me aktivitetin e prokurimit dhe që e kufizon shumë konkurrencën.

Kërkojmë nga AK- që kërkesa për Tre Saldues për gyp HDPE, të çertifikuar sipas EN-13067 të ndryshohet Duke e zvogëluar numrin e saldueseve.

Pretendim i 3:

Kërkesa 22.Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik në dosje të tenderit, Aneksin 7 të DT

- 1 (nje) Luge ngarkuese, kapaciteti i luges 1m3

Kërkesa që kapaciteti i lugës ngarkuese të jete 1 m3 pa tolerance (zakonisht për këtë pajisje caktohet – max 1 m3) është kërkesë jo proporcionale me aktivitetin e prokurimit dhe që e kufizon shumë konkurrencën.

Kërkojmë nga AK- që kërkesën për kapacitetin e Lugës ngarkuese ta ndryshoj.

Lidhur me pretendimet ankimore, vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se *"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik"*.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 14.04.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.